



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**NJOFTIM**

Ju lutemi, gjeni më poshtë njoftimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, e cila do të zhvillohet ditën e **Hënë datë 22 Korrik 2024, ora 16:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të nenit 53 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ju përcjell për shqyrtim dhe diskutim, pikat e rendit të ditës, si më poshtë:

1. Projektvendim “Për miratimin e vënies në funksion të shërbimit me kohë të plotë dhe ushqim të çerdheve me vendndodhje në Lagjen nr. 12 dhe në Lagjen nr. 13”.
2. Projektvendim “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Teda Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
3. Projektvendim “Për miratimin e draft marrëveshjes së grantit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin dhe ndërtimin e sheshit fundor të Bulevardit të Ri të Tiranës”.
4. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024, të ndryshuar”.
5. Projektvendim “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2025-2027.
6. Projektvendim “Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, Bashkisë Tiranë dhe qendrës “Tech Piramida” për zhvillimin e projektit “Ecole 42”.
7. Projektvendim “Për zhvillimin e pronave nr. 7/87 (pjesërisht), 7/292, 7/26, 7/41, 7/295, 7/70 dhe nr. 7/57, zona kadastrale 8330, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e draft kontratës së sipërmarrjes me kusht shkëmbimi midis Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë “StarTek” sh.p.k.”
8. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 101, datë 19.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për kompensimin e biletës së pajtimit mujor, të përgjithshëm (abonesë së studentit) për studentët e pajisur me kartë studenti për të gjitha linjat, në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës”, të ndryshuar”.

Ju faleminderit,

Romina Kuko

Kryetare e Këshillit Bashkiak

#### **MBLEDHJET E KOMISIONEVE**

**Komisioni i Edukimit dhe Infrastrukturës Arsimore**, do të shqyrtojë pikën **1** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e **premtë, datë 19 korrik, ora 10:00**.

**Komisioni i Financave dhe Buxhetit**, do të shqyrtojë pikat **2,3,4, 5** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e **premtë, datë 19 korrik, ora 11:00**.

**Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale**, do të shqyrtojë pikat **2,3,6,7,8** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e premtë, datë 19 korrik, ora 13:30**.

**Komisioni i Teknologjisë dhe Informacionit**, do të shqyrtojë pikën **6** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e **premtë, datë 19 korrik, ora 15:30**.